

VENDIM
Nr. 411, datë 4.7.2018

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA KESH SHA TEK AGJENCIA
PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË, TË KATIT IV TEKNIK TË OBJEKTIT ME NR.
PASURIE 3/44, QË NDODHET NË ZONËN KADASTRALE NR. 8260, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga KESH sh.a. tek Agjencia për Efiçencën e Energjisë, të katit IV teknik të objektit me nr. pasurie 3/442, që ndodhet në zonën kadastrale nr. 8260, me adresë: bulevardi “Bajram Curri”, rruga “Viktor Eftimiu”, ish-godina e KESH-it, Tiranë, sipas planimetrisë që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për ushtrimin e aktivitetit të këtij institucioni për të cilin është krijuar.

2. KESH sh.a. të marrë masa për dorëzimin e ambienteve në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

3. Agjencisë për Efiçencën e Energjisë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të objektit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë apo t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, KESH sh.a., Agjencia për Efiçencën e Energjisë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLANIMETRIA E MOBILIMIT TE KATIT KATERT

